

L I G J
Nr.8544, datë 4.11.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES DHE PROTOKOLLIT SHITESË “PËR RIJIMIN E
FORCËS SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja dhe Protokolli shtesë “Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore””, të nënshkruara përkatësisht më 26.9.1998 dhe 12.1.1999.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2482, datë 9.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

**MARRËVESHJA DHE PROTOKOLLI SHITESË "PËR KRIJIMIN E FORCËS
SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE"**

Shtete-Palë të kësaj Marrëveshjeje, më poshtë konsiderohen Palë,
Duke riafirmuar vullnetin dhe dëshirën e tyre për synimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara,

Të vetëdijshëm për faktin që kooperimi politiko-ushtarak është bërë një element kyç në forcimin e kapaciteteve të Europës në fushën e sigurimit dhe të mbrojtjes,

Me besimin që kooperimi dhe dialogu ndërmjet vendeve të rajonit të Europës Juglindore duhet zhvilluar më tej,

Me vullnetin për të kontribuar në përmirësimin e ndërveprimit,

Duke vlerësuar angazhimin e tyre për të kontribuar në sigurimin e stabilitetit rajonal dhe për të kultivuar marrëdhënie të fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të Europës Juglindore dhe në kuadrin e Mbledhjes së Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore, në kuadrin e Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik dhe në kuadrin e iniciativës “In the Spirit of Pfp” bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Përcaktimet

1. Në këtë Marrëveshje shprehja :

a) “Coalition of Willing” do të thotë që një grup shtetesh, bazuar në preferencat dhe vendimet e tyre individuale, formojnë një koalicion me qëllim të pjesëmarrjes aktuale në dhe/ose sigurimin e ndonjë lloji mbështetjeje politike, logjistike për operacione të veçanta.

b) “Ndalim Konflikti” do të thotë veprimtaritë, zakonisht të organizuara sipas kreut VI të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ato variojnë nga iniciativat diplomatike deri në dislokime parandaluese të forcave, me synim ndalimin e mosmarrëveshjeve para se ato të përshkallëzohen në konflikte të armatosura ose të përhapen. Parandalimi i konflikteve mundet që gjithashtu të përfshijë

misione të njohjes së gjendjes, konsultime, paralajmërime, inspektime dhe monitorime.

c) “Contingency Establishment (CE)” do të thotë një plan (në formë tabelle) që parashtron rishpërndarjen e autorizuar të fuqisë njerëzore dhe masat për zgjerimin e personelit të shtabit të forcave nën konditat operacionale.

d) “Contingency Operation Plan (COPs)” janë planet e zhvilluara për operacione të mundshme, ku faktorët planizues (p.sh. fusha, forcat, destinacioni, rreziqet, rajoni i operacioneve etj.) janë të identifikuar ose presupozohen të jenë të tilla. Këto plane përpunohen në detaje sa më të hollësishme, ku përfshihen edhe forcat e nevojshme dhe obsionet e dislokimit, si bazë për planizimin aktual të operacioneve në vazhdim.

e) “Deployment”, do të thotë rivendosje e forcave në rajonin e dëshiruar të operacioneve.

f) “Employment”, do të thotë përdorim i forcës në teatrin e operacioneve.

g) “Humanitarian Operations”, do të jenë operacione të drejtuara për të lehtësuar vuajtjet. Operacionet Humanitare mund të paraprijnë ose shoqërojnë veprimtari humanitare të siguruar nga organizma të posaçëm civilë.

h) “Operation and Maintenance”, do të jenë të gjitha veprimtaritë që sigurojnë përdorim efektiv të infrastrukturave me financim të përbashkët, në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë ndërtuar ose përshtatur dhe për të ruajtur këtë infrastrukturë gjatë periudhës së përdorimit në kondita të përshtatshme me kriteret dhe standardet për të cilat ajo është projektuar dhe ndërtuar.

i) “Organization of Action (ORACT)” është struktura përfundimtare e përcaktuar e Brigadës Shumëkombëshe të Europës Juglindore të paraqitura në formë tabelore.

j) “Peace-building” janë veprimtari, të cilat përfshijnë masat dhe strukturat politike, ekonomike, shoqërore e ushtarake që synojnë në forcimin dhe konsolidimin e marrëveshjeve politike, me qëllim që të mënjanojnë shkaqet e konfliktit. Kjo përfshin mekanizmat për identifikimin dhe mbështetjen e strukturave që synojnë të konsolidojnë paqen, të forcojnë masat e besimit e të mirëqenies dhe të mbështetjen rindërtimin ekonomik e civil të shoqërisë.

k) “Peace Enforcement” janë përgjithësisht operacionet e organizuara sipas kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ato janë të detyrueshme në natyrë dhe drejtohen kur nuk është arritur akoma pëlqimi i Palëve për një konflikt ose është në fazë pasigurie për t’u arritur. Këto operacione organizohen për të ruajtur ose rivendosur paqen ose të imponojnë kushtet e specifikuar në mandat.

l) “Peacekeeping” janë përgjithësisht operacionet e ndërmarra në zbatim të kreut VI të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe që organizohen në përputhje me pëlqimin e të gjithë Palëve në konflikt për të monitoruar dhe lehtësuar zbatimin e Marrëveshjes së Paqes.

m) “Peacemaking” janë veprimtaritë diplomatike të organizuara pas fillimit të një konflikti, me qëllim që të arrijnë në një ndalim zjarri ose një përfundim të shpejtë të konfliktit dhe vendosjen e paqes. Këto lloje veprimtarish mund të kërkojnë organizma, mediator, këshillime kompetente, si dhe masa detyruese diplomatike, izoluese ose sanksione.

n) “Peace Support Operations” janë operacione shumëkombëshe të organizuara njëanshmërisht në mbështetje të një mandati të KB/OSBE-së që përfshijnë forcat ushtarake, mjetet diplomatike dhe agjencitë humanitare, të ngritura për të arritur një zgjidhje afatgjatë ose kondita të tjera të specifikuar në mandat. Ato përfshijnë operacione paqeruajtëse dhe paqedetyruese, si dhe operacione parandaluese të konflikteve, paqebërje, paqendërtuese dhe humanitare.

o) “Personnel Establishment” (PE) janë planet që parashtrojnë struktura të zakonshme organizative të autorizuar dhe kërkesat për personel të Shtabit të Forcës.

p) “Rules of Engagement (ROE)” janë udhëzimet që i jepen forcave ushtarake (përfshi çdo person), që përcaktojnë rrethanat, kushtet, shkallën dhe mënyrën me të cilën forcat ose veprimet që mund të konsiderohen si provokative, mund ose jo të gjejnë zbatim. Rregullat e angazhimit nuk do të aplikohen në dhënien e detyrave ose udhëzimeve taktike. Me përjashtim të rasteve për vetëmbrojtje, gjatë operacioneve, rregullat e angazhimit sigurojnë autoritetin e vetëm për përdorimin e forcave.

r) “Transfer of Authority (TOA)” do të thotë transferim zyrtar i shkallëve specifike të autoritetit mbi forcat e caktuara ndërmjet një Pale dhe Komandantit të SEEBRIG ose ndërmjet dy komandantëve vartës.

s) “Voluntary National Contribution (VNC)” është subjekt i aprovimit të Komitetit Drejtues Politik-Ushtarak e kompletuar vullnetarisht nga Palët e Shtabit të Brigadës ose formacioneve të tjera shumëkombëshe, jashtë fushës së strukturës organizative dhe kërkesave për personel, për një periudhë të kufizuar kohore dhe për të përmbushur kërkesat specifike të ekspertizës.

Neni 2 **Parimet**

1. Palët garantojnë që veprimtaritë e Forcës Shumëkombëshe të Paqes të Europës Juglindore (MPFSEE/Force) ose Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG/Brigadë) siç vendoset këtu janë në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

2. Kjo iniciativë:

a) nuk drejtohet kundër ndonjë pale të tretë dhe as nuk synon të krijojë një aleancë ushtarake të ndonjë forme kundër ndonjë vendi ose një grupi vendesh;

b) është transparente dhe e hapur për NATO-n dhe vendet partnere në rajon, “të aftë dhe me vullnetin” për të kontribuar në mënyrë konstruktive, në çdo fazë në vazhdim;

c) do të jetë në përputhje dhe në mbështetje të programeve të PpP, të cilat synojnë në përmirësimin e kooperimit rajonal brenda PpP dhe do të bëjë të mundur një kooperim të rëndësishëm brenda kuadrit të Kombeve të Bashkuara (KB), NATO-s dhe Organizatës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE) dhe me Bashkimin Europiano-Perëndimor.

3. Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në ndonjë lloj mënyre në të drejtat dhe detyrimet e Palëve që burojnë nga traktatet që ata kanë nënshkruar më parë.

4. Të gjitha vendimet lidhur me MPFSEE do të merren me konsensusin e arritur ndërmjet Palëve.

Neni 3 **Krijimi, dislokimi dhe përdorimi i Forcës Shumëkombëshe të Paqes të EJJ**

1. Palët në këtë Marrëveshje krijojnë Forcën Shumëkombëshe të Europës Juglindore (MPFSEE) në nivel brigade. Vendndodhja e Shtabit/personeli kryesor i shtabit do të vendosen me konsensus ndërmjet Palëve.

2. Brigada do të deklarohet në Kombet e Bashkuara dhe OSBE-ja. Ajo do të jetë në dispozicion, në përshtatje me kapacitetet e saj, për përdorim në parandalim konfliktesh dhe në operacione të tjera të mbështetjes së paqes, përfshi operacionet e paqeruajtjes, paqëndërtimit dhe humanitare.

3. Forca do të jetë në dispozicion për përdorim të mundshëm në operacione të parandalimit të konflikteve ose operacionet e mbështetjes së paqes me mandatin e Kombeve të Bashkuara ose OSBE-së nën udhëheqjen e NATO-s ose BEP-it. Ajo gjithashtu do të marrë pjesë në “Coalition of willing – koalicioni i vullnetit të mirë”, lloj initiative ndërkombëtare. Forca gjithashtu do të funksionojë në kuadrin e “in the spirit of PpP”.

4. Vendimi për pjesëmarrjen në operacione dhe detyra dislokimi, të cilat fillimisht duhet të propozohen nga Komiteti Drejtues Politik-Ushtarak (PMSC) do të jetë subjekt i konsultimeve politike dhe ushtarake, siç parashtrohen në artikullin IV dhe do të aprovohen nga Palët nëpërmjet procedurave ligjore kombëtare respektive.

5. Pas marrjes së vendimeve të përbashkëta politike në baza “rast pas rasti” për pjesëmarrjen në operacione dhe për detyra për dislokim të forcave nga Palët, ata duhet të japin kontributet e tyre në dispozicion të forcave brenda kuadrit kohor të propozuar nga autoritetet përkatëse dhe të vendosur nga PMSC. Pjesëmarrja në një “pakt” force të veçantë për operacione specifike do të jetë në preferencat e plota kombëtare.

6. Detyrat që do të ndërmerren brigada dhe Rregullat e Angazhimit (ROE) do të burojnë nga rezolutat e organizatave ndërkombëtare, të cilat kanë marrë përsipër përmbushjen e një operacioni të dhënë dhe duhet të jenë subjekt për aprovim nga Palët, bazuar në propozimet e bëra nga KDPU.

7. Në operacionet e mbështetjes së paqes nën udhëheqjen e NATO-s ose të BEP-it, brigada do të jetë në vartësi të organizmave të caktuar në mandatin e organizatës ndërkombëtare përkatëse, pasi Palët të kenë rënë dakord për të ndërmerret të tillë operacion. Organizmi ushtarak nën të cilin do të funksionojë brigada, do të vendoset në mënyrë të përbashkët nga Palët.

8. Brigada duhet të tërhiqet nga operacionet në përputhje me një vendim të përbashkët të marrë nga Palët që angazhojnë forcat e tyre në këtë operacion.

9. Çdo Palë rezervon të drejtën të tërheqë forcat e saj dhe/ose personelin nga një operacion i

dhënë, me kusht që të gjithë Palët e tjera të jenë të informuara dhe ftuara në konsultime jo më vonë se 30 ditë para se të fillojë zbatimi i këtij vendimi.

Neni 4

Konsultimet politiko-ushtarake dhe marrja e vendimit

1. Konsultimet politiko-ushtarake dhe marrja e vendimeve do të përmbushen nëpërmjet mbledhjeve të Ministrave të Punëve të Jashtme, Ministrave të Mbrojtjes, Shefave të Shtabeve të Mbrojtjes dhe Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak (PMSC).

2. Ministerialet e Ministrave të Punëve të Jashtme synojnë të përqendrohen në çështjet politike të operacioneve ushtarake siç janë, anëtarësime të reja, pjesëmarrja në Forcë, përfshirja në iniciativat e paqes dhe/ose operacione të mbështetjes së paqes, parashikimi i të papriturave, marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare, rishikimi dhe përmirësimet e Marrëveshjes dhe dokumentet që lidhen me të dhe udhëzimet e përgjithshme politike.

3. Mbledhjet e Ministrave të Mbrojtjes duhet të rishikojnë çështjet ushtarake dhe të marrin vendime/japin rekomandime, kur është e përshtatshme, në veçanti pjesëmarrjen në operacione, udhëzimet e përgjithshme për përdorimin e Forcës, Rregullat e Angazhimit, aprovimi i Konceptit të Operacioneve (COPs) dhe Planet Operacionale.

4. Mbledhjet e Shefave të Shtabeve të Mbrojtjes janë të formës këshillimore për konsultime të nivelit të lartë ushtarak, të cilat sigurojnë kushte për diskutime të çdo çështjeje të natyrës teknike ushtarake dhe për të dhënë rekomandime në lidhje me këto çështje.

5. Mbledhjet e Ministerialit të MPFSEE dhe mbledhjet e Shefave të Shtabit të Mbrojtjes të MPFSEE duhet të organizohen të paktën një herë në vit, ose në përgjigje të një ftese nga njëra prej Palëve.

6. Komiteti Drejtues Politiko-Ushtarak do të krijohet si një organ i përbashkët ekzekutiv për mbikqyrjen dhe sigurimin e udhëzimeve politike për dislokimin, përdorimin dhe veprimtari të tjera të MPFSEE.

7. Për MPFSEE, çdo Palë do të caktojë një delegacion, i kryesuar nga një përfaqësues i lartë, i cili mund të këshillohet nga ekspertë të fushës përkatëse.

8. Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kryetari i PMSC do të funksionojë në formë rotacioni në baza vjetore ndërmjet Palëve.

9. PMSC do të përcaktojë organizimin e saj - siç ose në qoftë se mendohet e nevojshme dhe rregullat e brendshme duke iu përmbajtur parimeve të përgjithshme si më poshtë:

a) Ai do të mbledhet rregullisht në intervale kohore të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e tij dhe në një kohë shumë të shpejtë në përgjigje të një kërkesë të veçantë nga çdo Palë ose ftesë të bërë nga Kryetari.

b) Mbledhjet e rregullta do të zhvillohen dy herë në vit, në pranverë dhe vjeshtë dhe do të organizohen nga Pala që ka Kryetarin. Kjo Palë do të marrë përsipër edhe përgjegjësitë për sekretariatit.

c) Të gjitha vendimet do të merren me konsensusin e të gjithë pjesëmarrësve.

10. PMSC mund të krijojë grupe pune vartëse në baza ad-hok për t'u marrë me çështje të hollësishme të fushave specifike, sipas nevojave.

11. Roli parësor i PMSC ka të bëjë me sigurimin e tablove për të arritur përputhshmërinë e harmonizimin me qëllimet dhe parimet e parashtruara në Marrëveshje.

12. PMSC do të përpunojë politika dhe udhëzime për aprovim nga Ministerialet, të nevojshme për të mundësuar funksionimin efektiv dhe përdorimin e MPFSEE në fushat si më poshtë :

a) Programet vjetore përfshi programin e stërvitjeve dhe përgatitjeve, bazuar në propozimet e Komandantit të MPFSEE.

b) Administrimin dhe kooperimin e të dhënave fillestare të kontributeve të trupave të kandidueshme dhe të përshtatshme për MPFSEE.

c) Propozimet lidhur me dislokimet e mundshme.

d) Politika e përdorimit përfshi udhëzimet për përdorimin e Forcës dhe Rregullat e Angazhimit (ROE-s).

e) Mbështetja logjistike, përfshi – por nuk është e kufizuar për – Shtabin e Forcës, Personelin

Kyç të Shtabit dhe buxhetet e stërvitjeve.

f) Buxheti i përbashkët, përfshi – por jo i kufizuar për – Shtabin e Forcës, Personelin Kyç të Shtabit.

g) Ristrukturimin e Forcës dhe të komandës dhe organizimi i drejtimit kur është e nevojshme.

h) Marrëdhëniet me formacionet e tjera të ngjashme, në kuadrin e KB-së, NATO-s, OSBE-së dhe BEP-it.

i) Politika e informimit publik.

j) Rishikimi i kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve që lidhen me të për veprim të mëtijshëm sipas nevojës.

k) Çështje të ndërveprimit dhe të standardizimit.

13. PMSC do të rishikojë aplikimet e reja - përfshi ripërcaktimin e vendeve të PE - për pjesëmarrje në MPFSEE dhe ai do të bëjë rekomandimet për aprovimin e Ministerialit.

14. Për më tepër, PMSC do të ketë autoritetin për të:

a. aprovuar Planet e Përgjithshme të Operacioneve të Mundshme (COPs), të përgatitur nga Personeli Kyç i Shtabit, sipas udhëzimeve të Ministrave të MPFSEE;

b. parashikuar përgatitjen e planeve operacional e aktuale dhe të nënshkruajë ato për aprovim në Ministerial;

c. vendosur standarde për stërvitjen e njësisë;

d. aprovuar doktrinën për MPFSEE;

e. aprovuar dokumentet e stërvitjes - siç mendohet e nevojshme - përgatitur nga Shtabi i Forcës;

f. aprovuar Direktivën e Sigurimit të Informacionit të MPFSEE;

g. vendosur ekupe të përbashkëta për vlerësimin e nivelit të gatishmërisë të njësisë në përputhje me standardet dhe rregullat e vendosura.

15. PMSC gjithashtu do të jetë përgjegjës për:

a. mbikëqyrjen e realizimit, fondimet, kompletimit - përfshi nënshkrimin e kompletimit të Kontributit Vullnetar Kombëtar - dhe mbështetjen e Personelit Kyç të Shtabit, përfshi aprovimin e Buxhetit të Shtabit të Forcës;

b. rishikimin e Termave të Referencës për Komandantët, Zëvendëskomandantin dhe Shefin e Shtabit, sipas nevojës.

16. KDPU do të dorëzojë raporte për t'u shqyrtuar në Ministerialet dhe në mbledhjet e Shefave të Shtabit të Mbrojtjes, çdo vit/ose sipas nevojave.

17. Kostot e Konferencave dhe të veprimtarive të tjera administrative që lidhen me mbledhjet e KDPU, përveç kostos së udhtimit dhe akomodimit, në parim do të mbulohen nga vendi pritës.

Neni 5

Gjuha

Gjuha e punës të MPFSEE do të jetë anglisht.

Neni 6

Struktura e Forcës

1. Forca përbëhet vetëm nga elemente tokësore, meqenëse nuk është parashikuar ndonjë pjesëmarrje direkte e shërbimeve ajrore dhe detare (përveç grupit të Kontrollit Taktik Ajror, TACPs). SEEBRIG, do të jetë një forcë "ON-CALL" që do të thirret në detyrë mbështetur nga elemente nga shërbime të tjera, si dhe kur është e nevojshme.

2. Njësitë e caktuara në këtë Forcë do të qëndrojnë në bazat e tyre kombëtare të përhershme dhe do të bashkohen për të krijuar forcën e përshtatshme për veprimtari stërvitore, përgatitje në përputhje me programet e përpiluara bashkërisht, dhe në raste të paparashikuara vendimi do të hyjë në fuqi kur ai të aprovohet nga Palët.

3. Palët do të formojnë njësi të veçanta dhe/ose kapacitetet së bashku me pajisjet nga struktura e forcave të armatosura në vendet e tyre respektive, të cilat do të përfshihen në përbërjen e Brigadës. Njësitë respektive do të qëndrojnë brenda strukturës së komandimit kombëtar, derisa ato të deklarohen gati për mision dhe do të kenë hyrë në vartësi të komandës së përbashkët p.sh. COMSEEBRIG.

4. Njësitë bazë të Forcës do të jenë të madhësisë së batalionit. Çdo batalion do të përbëhet nga 2-3 kompani, forca të mbështetjes së luftimit dhe shërbime të mbështetjes së luftimit (logjistikat). Batalionet mund të jenë shumëkombëshe. Njësitë, në parim, duhet të jenë të vetëfurnizueshme.

5. Hollësi të nevojshme lidhur me Strukturën e Forcës përfshi kontributet/angazhimet dhe procedurat për të qëndruar në Organizimin me të kohës të Veprimeve (ORACT) janë në Aneksin-A (Struktura e Forcës). Procedurat për Transferimin e Autoritetit (TOA) dhe për Procesin e Gjenerimit të Forcës do të gjenden në Aneksin-B (Gjenerimi i Forcës).

Neni 7

Struktura e komandimit dhe drejtimit

1. Struktura e Shtabit të Forcës përfshi personelin kyç të Shtabit, CE për Shtabin e Forcës dhe PE për Personelin Kyç të Shtabit përfshihen në Aneksin-C (Shtabi i Forcës) të kësaj Marrëveshjeje. Vendet në Shtab, përveç Grupit të Komandës së Brigadës, duhet të vendosen tek Palët në përputhje me pjesën e kontributeve respektive të forcës.

2. Grupi i Komandës së Brigadës duhet të jetë i përbërë nga Komandanti i Brigadës, dy zëvendës, Shefi i Shtabit dhe dy zëvendës shefa shtabi. Komandanti i Brigadës duhet të zëvendësohet (ndërrohet) nga detyra një herë në dy vjet nga një Gjeneral Brigade i forcave tokësore të Palëve pritëse, ndërsa detyra e shefit të shtabit do të zëvendësohet (ndërrohet) nga një kolonel i vendit Pritës. Postet kyçe të komandës do të ndërrohen në formë rotacioni një herë në 2 deri 3 vjet ndërmjet Palëve. Intervali ekzakt i rotacionit do të jetë çështje e konsultimeve të mëparshme. Vendi Pritës do të përjashtohet nga rotacioni i Komandantit, Zëvendëskomandantëve dhe Zëvendësshefave të shtabit.

3. Shtabi i Forcës duhet të jetë plotësisht në veprim për stërvitje dhe operacione. Përveç këtyre rasteve, një Shtab bërthame permanent do të funksionojë nën komandën e Komandantit të SEEBRIG.

4. Shtabi Bërthamë, në koordinim dhe konsultim të ngushtë me Shtabet respektive kombëtare, do të zhvillojë Procedurat Standarde të Veprimit (SOPs), të dhënat bazë dhe mundësitë për lëvizje strategjike të nevojshme për të ulur kohën e planizimit dhe të përhapjes në rendim luftimi para çdo dislokimi aktual. Ai do të planizojë dhe përgatitet për drejtimin e trajnimit dhe stërvitjeve operacionale dhe logjistike, në bazë të diskutimeve të Komitetit Drejtues Politik-Ushtarak. Ai duhet të zhvillojë Planet e Përgjithshme të Mundshme të Operacioneve dhe duhet të marrë pjesë në misionet të zbulimit të gjendjes që do të drejtohen në kuadrin e përgatitjeve për misionet përfshi dislokimin dhe përdorimin e Brigadës.

5. I gjithë personeli i caktuar në CE në parim do të dislokohe në Shtabin e Brigadës gjatë operacioneve, pavarësisht nga pjesëmarrja kombëtare në një pakt force të përshtatur për një operacion specifik.

6. Kompania e Shtabit së bashku me Kompaninë e Ndërlidhjes do të qëndrojnë në gatishmërinë e duhur për të siguruar mbështetje të personelit kyç për funksione parësore.

7. Komandanti i Brigadës do të ketë të drejtën e dhënies së urdhrave njësisë vartëse kur SEEBRIG zhvillon stërvitje të përbashkëta, përgatitet për veprime në një rajon të operacioneve ku do të marrë pjesë SEEBRIG dhe për kohëzgjatjen e operacioneve të tilla. Këto njësi do të kenë detyrimin për të zbatuar urdhrat e marra, me kusht që ato nuk do të jenë në kundërshtim me ligjet e brendshme të vendit, qytetarë të të cilit ata janë dhe me konditë që ato të jenë në përputhje me synimet dhe parimet për të cilat janë krijuar Forcat, në përputhje me mandatin e veprimit të forcave dhe me Rregullat e Angazhimit të forcave.

8. Komandanti i Forcës do të dorëzojë një raport vjetor dhe raporte të gjendjes, sipas nevojës në KDPU me kopje informative për autoritetet ushtarake përkatëse të Palëve.

Neni 8

Veprimtaritë stërvitore

1. Veprimtaritë, si stërvitjet dhe përgatitjet stërvitore të njësisë, vizitat, përnjohja, periudhat e studimit për planëzim dhe zhvillimi i koncepteve, kurset dhe trajnimi gjuhësor do të zhvillohen me qëllim të rritjes së efektivitetit të Forcës.

2. Palët do të jenë përgjegjëse për stërvitjen e njësisë të tyre në vendbazimet e tyre permanente dhe në ambientet kombëtare stërvitore në përputhje me standardet e vendosura bashkarisht.

3. Stërvitjet e përbashkëta përfshi veprimtaritë e rikonicionit, stërvitjet komando-shtabi/ dhe me trupa dhe stërvitjet për menaxhimin e krizave do të drejtohen në përputhje me planet e programet e rëna dakord bashkërisht.

Neni 9

Sigurimi i informacionit

1. I gjithë informacioni i klasifikuar që shkëmbehet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është subjekt i ruajtjes së barabartë në përputhje me klasifikimin e dhënë nga burimi i dhënies dhe në përputhje me legjislacionin detyrues (kufizues) të brendshëm të çdo Palë që merr këtë informacion.

2. Palët nuk kanë të drejtë të bëjnë të ditur (japin) çdo informacion të tillë te një Palë e tretë pa pëlqimin me shkrim të dhënësit të informacionit.

3. Kriteret dhe metodat më të detajuara për sigurimin e informacionit të klasifikuar do të organizohen përfundimisht në Direktivën e Sigurimit të Informacionit të MPFSEE, që do të miratohet nga PMSC.

Neni 10

Logjistikat

1. Në parim logjistikat janë përgjegjësi kombëtare. Çdo Palë është përgjegjëse për mbështetjen logjistike të trupave të saj përfshi këtu edhe lëvizjen strategjike si gjatë stërvitjes dhe dislokimit të Forcës për një rast të papritur. Për më tepër, Palët janë të përgjegjshme për organizimin dhe pajisjen e trupave të tyre me pajisje të standardizuara/ dhe të ndërveprueshme.

2. Një sistem reciprok i logjistikës duhet të zhvillohet ndërmjet Palëve. Marrëveshje të veçanta/Memorandume Mirëkuptimi do të përfundohen, mbi baza rast-pas-rasti, për të specifikuar parimet e sigurimit të mbështetjes logjistike gjatë operacioneve dhe stërvitjeve.

3. Pala ku është Shtabi i SEEBRIG do të sigurojë personelin kyç të Shtabit me:

a. Ambientet e Shtabit (përfshi komunikimin), pa pagesë,

b. Shërbimin mjekësor (jo i Forcës) pa pagesë nga Shërbimi shëndetësor i Forcave të Armatosura, për personelin Kyç të Shtabit dhe familjarëve të tyre.

c. Trajtimet urgjente në spitale civile ose ushtarake pa ndonjë rimbursim.

d. Karburant dhe lubrifikant në bazë rimbursimi.

e. Të gjitha furnizimet permanente, mobiljet dhe pajisjet bazë të Shtabit të Forcës.

4. Vendi Pritës do të veprojë si Axhent Prokurimi dhe Kontraktimi në emër të Shtabit të Forcës në çështjet e blerjeve, qerave dhe Marrëveshjeve të tjera ligjërish të detyrueshme, bazuar në buxhetin e aprovuar.

5. Aneksi-D (Mbështetja e Vëndit Pritës) specifikon parimet dhe të gjithë detajet e nevojshme për mbështetjen e Vëndit Pritës përfshi ato në paragrafet 3 dhe 4.

Neni 11

Çështjet Ligjore

1. Dispozitat e SOFA-s PpP (Marrëveshja Ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të Tjera që marrin Pjesë në Partneritetin për Paqe, përfshi këtu Statusin e Forcave të Tyre) dhe Protokolli Shtesë, përfunduar më 19 qershor 1995, do të jenë plotësisht të zbatueshëm, ndryshimet e nevojshme të bëra (mutatis mutandis) në këtë Marrëveshje, duke ndjekur plotësimin e proceseve të ratifikimit të këtyre instrumentave nga Palët. Në qoftë se në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të ketë ende Palë që nuk e kanë ratifikuar dokumentin SOFA PpP, statusi ligjor i Forcës do të përcaktohet me anën e një Marrëveshjeje të Veçantë ndërmjet Palëve.

2. Marrëveshjet e veçanta, mbi bazë rast-pas-rasti, do të specifikojnë statusin e forcave kur është dislokuar Brigada për operacione të mbështetjes së paqes.

3. Personeli Kyç i Shtabit dhe pjesëtarët e tyre të familjes do të përfitojnë nga lehtësitë ushtarake dhe në kondita të barabarta/ me gradë të krahasueshme/shkallë personeli të Vëndit Pritës në përputhje me udhëzimet në fuqi.

4. Aneksi-A deri në aneksin E janë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Çështjet financiare

1. Kostot fillestare, të specifikuara në Aneksin-D (Mbështetja e Vendit Pritës) për krijimin e Shtabit permanent të forcës do të financohen nga Vendi Pritës.

2. Shpenzimet e përbashkëta, përfshi kostot operacionale dhe për mirëmbajtje (O&M) do të ndahen ndërmjet Palëve, në proporcion me nivelin e tyre të pjesëmarrjes brenda PE të Shtabit të Forcës.

3. Pajisjet e blera me anën e fondeve të përbashkëta do të jenë pasuri e përbashkët e Palëve. Statusi i pasurisë së përbashkët dhe pajisjet kombëtare të siguruara nga vendi pritës për përdorim të përkohshëm, do të evidentohen në një listë të veçantë inventari dhe këto blerje do të përfshihen, si një listë e plotë në raportin vjetor.

4. Rrogat e personelit, kompensimet për jetesë dhe akomondim, kostot e transportit për shkuarjen dhe kthimin nga Shtabi i Brigadës dhe shpenzimet e tjera të ngjashme do të jenë përgjegjësi kombëtare.

5. Palët do të jenë përgjegjës për financimin e kontigjentit të tyre kombëtar gjatë stërvitjeve dhe përgatitjeve, gjatë fazës së përgatitjeve për dhe gjatë operacioneve të mbështetjes së paqes përfshi edhe furnizimin me pajisje të tyre me standardet e rena dakord.

6. Standarde dhe metoda me të hollësishme për çështjet financiare janë të dhëna në Aneksin-E (Financa).

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshje që vijnë nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve ndërmjet Palëve pa mbështetjen e juridiksionit të jashtëm.

2. Në rast se njëra Palë konkludon se Pala tjetër nuk pranon ose është e pamundur të pranojë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ajo atëherë mund të propozojë me shkrim mbajtjen e konsultimeve ndërmjet Palëve, të cilat duhet të fillojnë 30 ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim për këtë.

Neni 14

Përmirësimet dhe rishikimi

1. Palët mund të propozojnë çdo përmirësim (amendament) ose rishikim të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të anekseve të saj me shkrim dhe në çdo kohë. Në këtë rast konsultimet do të fillojnë 30 ditë pas marrjes të njoftimit zyrtar me shkrim për këtë.

2. Çdo amendament i tillë do të hyjë në fuqi kur pranohet nga të gjithë Palët.

Neni 15

Ratifikimi – Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje me pesë Aneksë do të jetë subjekt i ratifikimit. Të gjithë instrumentet e ratifikimit do të depozitohen në vendet ku kjo Marrëveshje është nënshkruar. Ajo do t'i bëjë të ditur Palët për çdo depozitim. Tridhjetë ditë pasi shtetet nënshkruese kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, kjo Marrëveshje ndërmjet Palëve hyn në fuqi. Për vendet që nuk kanë nënshkruar ende këtë Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas depozitimit të instrumenteve të tyre të ratifikimit.

2. Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, depozituesi informon KB, OSBE, NATO, dhe BEP për stabilizimin e Forcës.

Neni 16

Pranimi

1. Marrëveshja prezente do të qëndrojë e hapur për pranime të vendeve të tjera të NATO/PpP

në rajon, të aftë dhe me vullnetin për dhënien e një kontributi konstruktiv.

2. Pasi një vend i veçantë aplikon për pranim në këtë Marrëveshje, çështja do të merret për shqyrtim nga Ministrat e Jashtëm të Palëve.

3. Pasi të arrihen rezultate pozitive në diskutime për çështjen nga Ministrat e Punëve të Jashtme të Palëve, me konsensus, dhe aprovimin e vendimit për pranim së bashku me amendamentet e asocimit të kësaj Marrëveshjeje dhe të Anekseve të saj nga të gjithë Palët, vendit aplikues do t'i jepet mundësia të depozitojë instrumentat e tij të pranimin tek depozituesi (sekretari), i cili do të informojë përkatësisht Palët e tjera.

4. Çdo vend që pranon këtë Marrëveshje, ajo do të hyjë në fuqi 30 ditë pas depozitimit të instrumenteve të tij të pranimin.

Neni 17

Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një kohë të pacaktuar, deri sa Palët nuk do të marrin vendime të ndryshme mbi këtë Marrëveshje.

2. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të çënojë të drejtat e Palëve për të bërë aneksa mbi shpenzimet për trajnim, furnizime, përgatitjet dhe veprimtaritë e Brigatës.

Neni 18

Denoncimet

1. Marrëveshja prezente mund të denoncohet nga çdo Palë në çdo kohë.

2. Denoncimi duhet të bëhet me njoftim me shkrim i adresuar nga Pala te depozituesi.

3. Denoncimi do të ketë vlerë deri në një muaj pas marrjes së njoftimit. Pas një muaji Marrëveshja bie nga fuqia për Palën që e ka denoncuar atë, por kjo marrëveshje do të vazhdojë të qëndrojë në fuqi për Palët e tjera.

4. Në qoftë se brenda afatit që denoncimi mbetet në fuqi, do të ketë ende çështje financiare ose pretendime që ndikojnë Palën denoncuese dhe që nuk janë zgjidhur ende, Marrëveshja prezente do të konsiderohet të mbesë në fuqi për këtë Palë dhe nuk do të jetë në fuqi vetëm për çështjet për të cilat nuk janë siguruar zgjidhje përkatëse.

Kjo Marrëveshje me Anekset A deri në E, të përpiluara në origjinal Anglisht dhe të nënshkruar në Shkup më 26 shtator 1998, do të qëndrojë e depozituar në arshivën e vendit ku është nënshkruar kjo Marrëveshje. Kopje të përshtatshme të certifikuara do t'u jepen Palëve.

Anekset

Aneksi-A:	Struktura e Forcës
Aneksi-B:	Burimet e Forcës
Aneksi-C:	Shtabi i Forcës
Aneksi-D:	Mbështetja e Vendit Pritës
Aneksi-E:	Financa

Në emër të Shteteve-Palëve të kësaj Marrëveshjeje:

Zoti Luan Hajdaraga, Ministër i Mbrojtjes
Zoti Gueorgui Ananiev, Ministër i Mbrojtjes
Zoti Apostolos Tsohatzopoulos, Ministër i Mbrojtjes
Zoti Lazar Kitanoski, Ministër i Mbrojtjes
Zoti Beniamino Andreati, Ministër i Mbrojtjes
Zoti Victor Babuic, Ministër i Mbrojtjes
Zoti Ismet Sezgin, Ministër i Mbrojtjes